



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01-8939/23
Kaçanik, 24.04.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24 prill 2023. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarët- të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës –Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova-DUKMM, ndërkaq në pjesën e dytë të mbledhjes morën pjesë: Pranvera Loku-Zharku-DZHET dhe Dardana Tafili-Dauti. Nga zyrtarët ishte: Mavije Murseli.

Mbledhjen e monitoroj nga OSBE, Afrim Nesreti.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfîre Malsiu- zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstaton kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 24 prill, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti tre mujor financiar, Janar-Mars 2023;
3. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve nga Rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023;
4. Propozim Vendimi për Transfer dhe Rialokim të mjeteve buxhetore;
5. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK nr.00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin nerodime;
6. Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesë të Parcelave kadastrale 00431-5, 00431-6, 00431-7, 00411-0 në ZK Duraj, për Këmbim me pronën komunale ZK Duraj.

Lidhur me rendin e punës Kryesuesi i Kuvendit e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Rendi e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikëve.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri, pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së III (tretë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 27.03.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-6998/23.

2. Raporti tre mujor financiar, Janar-Mars 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kërkoj sqarime nga drejtori të HVK të tabela 1, buxheti i miratuar me buxhetin e tanishëm është i njëjtë, a është për shkak se mjetet nuk janë bartur ende? Shpenzimet për tre muaj nëse i krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit 2022, në kalkulim është bërë mirë, ndërkaq për krahasim e keni marrë vitin 2021. Të inkasimi i të HVK, çka keni dashur me paraqitur në këtë rast, pasi që krahasimi me të njëjtën periudhë, po del se janë inkasuar 7,452€. Të shpenzimet, shpenzimet keni arritur 15.35% nga buxheti i miratuar. Të subvencionet dhe transferet, krahasimi, progresi 3.7%, shpenzimet kapitale, 0.25%. Shuma d.m.th. është 7,000€ të investimet kapitale, se kur të dalim të mirëmbajtja e rrugëve, janë shpenzuar 63,254€. Të shpenzimet komunale, tabela e parafundit keni paraqitur krahasimin të TM2. Të subvencionet dhe transferet, a janë shpenzuar shuma 70,000€ të kultura, rina dhe sporti?

z. Bahri Selimi: Po, buxheti është i njëjtë, sepse ende nuk janë bartur mjetet e ngelura nga vitet paraprake. Krahasimi që është bërë, është bërë gabim teknik viti 2021, ndërkaq shifrat janë mirë të paraqitura. Edhe të inkasimi i të HVK, gabim është bërë teknik. Unë i përmirësoj gabimet dhe ua dërgoj edhe një herë materialin. Të shpenzimet kapitale, tre mujori i vitit të kaluar ka qenë jo me i vogël, vetëm 1,924€ janë paguar, ndërkaq sivjet i kemi mbi 7,000€. Nëse në tremujorin e parë organizatat buxhetore nuk kanë obligim të raportimeve të obligimeve, ne nuk kemi pasur të investimet kapitale shpenzime, ne nuk kemi pasur realizime. Shuma e mjeteve për mirëmbajtje të rrugëve janë mjete të shpenzuara nga mallrat dhe shërbimet. Planifikimi është të pjesa lartë, ndërkaq shpenzimi të pjesa poshtë, ne kemi shënuar buxheti, megjithatë mundemi me ua dërguar edhe një herë materialin. z. Selimi në vazhdim dha edhe sqarime tjera në pyetjet e z. Agim Mani.

Kryesuesi i Kuvendit: Të tabela tjetër është planifikimi dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore.

znj. Ardita Rrahmani: Unë kam një pyetje e cila është aktuale për komunat, çështjen e bartjes së mjeteve të ngelura të vitit 2021, edhe pse nuk janë shumë mjete, por për komunën tonë janë shumë. Ne, në mbledhjen e fundit të KK votuam bartjen e mjeteve mbi 300,000€ të vitit 2021 dhe mbi 400,000€ të vitit 2022, plus i kemi votuar projektet e parapara për realizim me ato mjete buxhetore. Shpenzimet me të mëdha do të shkojnë në ndërtimin e nënkalimit hekurudhor. Çka do të bëhet me këto projekte, nëse nuk lejohet bartja e mjeteve të vitit 2021?

z. Bahri Selimi: Mjetet e ngelura buxhetore të vitit 2021 po na ndalen jashtëligjshëm. Grupi parlamentar i LDK është angazhuar me së tepërmi që këto mjete mos t'iu ndalen komunave. Ne e kemi dërguar vendimin në qeveri ashtu siç është miratuar në KK, ndërkaq jemi detyruar me bërë një rishikim të mjeteve buxhetore të viteve 2021 dhe 2022. Mjetet të cilat mbetin fjalë vjen nga viti 2022 barten në vitin 2023 dhe ato mjete nuk mund të llogariten se janë të vitit 2022 kur kalojnë në vitin vijues fiskal, por ata nuk po i njohin si duket sa duhet financa.

Kryesues i Kuvendit: Kjo është një problematikë që na prekë konkretisht neve komunave, por që nuk e vendosim ne. Ne mundemi me diskutuar, por nuk mundemi të bëjmë asgjë në këtë drejtim,

znj. Ardita Rrahmani: Kryesues, ne e këna votuar bartjen e atyre mjeteve, kështu që po duam me ditur, çka bëhet me atë vendim të cilin e kemi votuar ?

Kryesues i Kuvendit: Vendimi është dërguar në MAPL, nëse është i kundërligjshëm, vendimin na i kthejnë në rishqyrtim.

z. Bahri Selimi: Vendimi nuk na kthehet në rishqyrtim. Ne duke ditur tendencat e qeverisë, i kemi ndarë mjetet e 2 viteve dhe i kemi propozuar projektet për realizim me ato mjete.

Kryesues i Kuvendit: Nëse vendimi i KK nuk kthehet nga autoriteti shqyrtues, atëherë është shkelje tjetër ligjore, sepse nëse vendimi nuk kthehet me u rishqyrtuar, ne duhet me zbatuar ashtu siç është miratuar.

z. Bahri Selimi: Prej momentit që mjetet e vitit 2021 nuk po lejohen me u bartë, ne jemi duke punuar me shkresa tjera me ministrinë, se vendimi nuk kthehet për rishqyrtim. Ne duhet tani me menaxhuar vetëm shumën e mjeteve të bartura të vitit 2022.

znj. Ardita Rrahmani: A mundemi me pas ne në një seancë të KK një informatë se cilat nga 15 projektet hiqen nga shuma e mjeteve 319,000€ të vitit 2021 dhe cilat projekte realizohen me mjetet buxhetore të mbetura të vitit 2022.

z. Agim Mani: Unë në mbledhjen e kaluar të KPF ia kam bërë të njëjtën pyetje drejtorit, edhe pse me është thënë se është pyetje pa lidhje. Unë e kam dëgjuar Asociacionin e Komunave të Kosovës se pezullohet bartja e mjeteve të vitit 2021. Unë kam menduar se drejtori ka informacione të nevojshme prej ministrisë dhe votuam për bartjen e mjeteve.

Kryesues i Kuvendit: Unë me qenë në ekzekutiv, e ekzekutoj vendimin ashtu si është miratuar për derisa vendimi është në fuqi, në të kundërtën MAPL duhet me kthyer vendimin në rishqyrtim. Vendimin nuk e kthen sepse vendimi është i ligjshëm. Për derisa vendimi nuk kthehet, atëherë duhet udhëhequr procedurat e ekzekutimit, ndërkaq janë gjykatat që e vlerësojnë vendimin, dhe janë shumë i bindur se gjykatat vendosin në favor të komunës, se nuk ka bazë ligjore mos me të lejuar me i shpenzuar mjetet e komunës (mendimi im). Unë mund të jam gabim, por përderisa nuk është kontestuar një vendim, atëherë vendimi është në rregull dhe unë nuk i kisha tërhequr projektet.

z. Bahri Selimi: Ata të ministrisë na e kanë dhënë sinjalin dhe kanë kërkuar që ne me dërguar planin për projektet që parashohim t'i realizojmë me mjetet e ngelura të vitit 2022.

znj. Ardita Rrahmani: Është dashur me lënë një plan B lidhur me mjetet e bartura, se ne e kemi votuar vendimin. Janë 15 prioritete të cilat krejt janë të rëndësishme që janë në interes të qytetarëve, dhe me votën e qytetarëve unë jam këtu me i përfaqësuar interesat e tyre, se janë disa prioritete që duhet me u realizuar. Bilancet e pashpenzuara janë votuar nga 95 deputet në Kuvendin e Kosovës për me u bartë në vitin vijues dhe ai vendim nuk po zbatohet. Në këtë mbledhje, besoj se mbledhja do të transmetohet drejtpërdrejtë, drejtori të del me informatë se cilat projekte kanë me u realizuar me mjete të bartura, në mënyrë që të kuptojnë qytetarët.

Kryesues i Kuvendit: Ju jeni anëtarë të KK dhe duhet me kërkuar zbatimin e vendimit. MAPL nuk na ka kthyer përgjigje, ndërkaq afati ligjor ka kaluar dhe vendimin duhet me publikuar. Mua me intereson, a jemi ne në rregull me vendimin? Nëse po, atëherë me u zbatuar vendimi. Nëse vendimi publikohet hynë në fuqi, atëherë drejtori duhet me i pasur mjetet për ekzekutim të vendimit. Nëse një vendim i KK nuk kthehet i kundërligjshëm, ai vendim është në harmoni me ligjin dhe duhet të zbatohet. Zyrtarja e KK i shkruar MAPL lidhur me vendimet e fundit të KK për çështjen e ligjshmërisë, dhe nëse nuk ka ndonjë konfirmim, vendimi do të publikohet.

znj. Kadrije Lika- Troni: Të raportit i buxhetit të komunës, të administrata e përgjithshme, të çështjet gjinore, desha me pyetur drejtorin, kërkesën të cilën e kemi adresuar Grupi jo formal i grave asambleiste për 100€, pse nuk u realizua kjo shumë buxhetore nga pozicioni i mallrave dhe shërbimeve, për aktivitete të festës së 8 Marsit?

z. Bahri Selimi: Festa e 8 Marsit është një festë e cila dihet se mbahet me atë datë. Zyrtari për barazi gjinore, Vedat Dema duhet me pasur parasysh këtë çështje për me bërë diçka rreth kësaj feste. Ndarja e mjeteve ka procedura, kështu që është dashur në fillim të vitit të adresohet kërkesa, se janë procedurat e tenderit të cilat marrin kohë. Petty Cash nga viti 2021 i kemi të lejuara vetëm 1000€ brenda një viti buxhetor. Këto janë të parapara zakonisht për defekte të vogla të cilat mund të ndodhin, si prishja e ndonjë reze deri, poqi elektrik e të ngjashme.

Kryesues i Kuvendit: Ju si Grup i grave asambleiste, mund të adresoni një kërkesë për aktivitete të këtij grupi jo formal, e procedojmë në KK dhe ndajmë shumën 1000€ nga pozicioni mallra dhe shërbime të mjeteve buxhetore të KK.

znj. Kadrije Lika- Troni: Afati ishte i shkurtër për adresimin e kërkesës tonë, ndërkaq në këtë rast. Zyra për barazi gjinore ka dështuar në planifikim, se ai është dashur me bashkëpunuar me ne.

z. Bahri Selimi: Ju e keni iniciuar si Grup i grave asambleiste këtë çështje, ne kemi biseduar me Vedatit dhe e kemi pyetur se, a ka të adresuar kërkesë në prokurim? Përgjigja e tij ka qenë jo. D.m.th. për me u realizuar një kërkesë përmes prokurimit, ka procedura.

znj. Ardita Rrahmani: Gjatë bisedave me Vedatin, unë kam kërkuar me ditur pse nuk janë përfshirë aktivitete për 8 Marsin. Kërkesat po duhet me i adresuar me email, se për ndryshe fjalë po harrohen. Çështja është se, nuk janë paraparë aktivitete të tilla, dhe ku po shkojnë mjetet për çështje gjinore ?

Kryesues i Kuvendit: Nëse doni me pasur buxhetin e juaj, ju si Grup i grave asambleiste, adresoni një kërkesë në një mbledhje të KK, ku i bëni planifikimet e juaja dhe pasi të miratohet kërkesa, menaxhoni ju vet me buxhetin e juaj, se mjete buxhetor ka të KK nga pozicioni i mallrave dhe shërbimeve.

z. Bahri Selimi: Buxheti ekziston për çështje të barazisë gjinore, por çështja është se duhet me shkuar përmes procedurës së prokurimit, ndërkaq çështja që kryesuesi ua plotëson aktivitetet edhe me mjete të kuvendit, ajo është diçka tjetër.

Nënkryetari i Komunës: Sabedin Vishi: Ju jeni bazuar në mjetet Petty Cash që ka komuna që ndahen pa procedurë, shuma e këtyre mjeteve është vetëm 1000€ për një vit fiskal.

Kryesues i Kuvendit: Ju mundeni me bërë Planin e veprimit dhe Planin financiar se ku me i orientuar mjetet për aktivitetet të cilat mendoni me i realizuar për gjatë një viti fiskal. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky propozim vendim t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Njoftohet

Me Raportin tre mujor financiar, Janar-Mars 2023. Ky raport financiar i procedohet KK për shqyrtim.

3. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve nga Rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023;

Kryesues i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Ne çdo vit kur e bëjmë buxhetin, ministria na i konteston disa mos përmbushje të kriterëve. Ne si komunë i kemi 120,000€ në rezervë sivjet. Rezerva mbesin derisa t'i plotësoj kriteret me i shndërruar në mjete kapitale. Ministria i lënë në rezervë, se këto mjete në fakt nuk janë rezerva shtetërore. Këto mjete i kemi planifikuar ku me i shpenzuar, përpos shumës 50,000€ të cilat DSHMS ende nuk i ka orientuar. Në vazhdim drejtori sqaroi për mjetet të cilat shkojnë në rrugë lokale, ndërkaq ato të drejtorisë së Arsimit theksoj se shkojnë për ndërtimin e kulmit të shkollës 'Qamil Ilazi' në Kaçanik të Vjetër.

znj. Ardita Rrahmani: Mjetet buxhetore të rezervës nga drejtoria e Arsimit, a shkojnë për ndërtimin e kulmit të shkollës 'Qamil Ilazi' në Kaçanik të Vjetër, të shkollës së re apo të shkollës së vjetër?

Kryesues i Kuvendit: Mjetet e drejtorisë së Arsimit shkojnë për ndërtimin e kulmit të shkollës së vjetër 'Qamil Ilazi' në Kaçanik të Vjetër.

z. Agim Mani: Parashtroj pyetje: Rezervat a janë të vitit të kaluar? Të HVK të pika 2.3, a janë të koduar për një projekt? Këtë po e themi sepse në vitin 2023 kemi bërë shumë kodime për projekte me nga 5,000€, e që tani po del se ne e kemi pasur mirë, se nuk ka pasur nevojë me bërë shumë kodime të projekteve pa i pasur mjetet.

z. Bahri Selimi: Rezervat janë të vitit 2023. Projekti të pika 2.3 është i koduar të kultura për pajime të ndryshme. Nuk i kemi specifikuar pajimet, plani ka ndryshuar dhe tani ato mjete kanë ngelur në rezervë.

znj. Ardita Rrahmani: Çështja është se po kodohen projektet, nuk po realizohen, kështu që mjetet po barten vit pas viti.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Kodimi i projekteve me shumën me nga 5,000€ nuk është planifikuar gabim, sepse është menduar në gjetjen e donacioneve për realizim të projekteve, qoftë nga ministria apo ndonjë donacion tjetër.

Kryesues i Kuvendit: Çështja e projekteve të koduara për projekte, dihet planifikimi për secilin projekt, mirëpo me ato projekte dihet se nuk realizohen, nëse nuk e ndihmon qeveria apo gjetjen e ndonjë donacioni tjetër, se ne e dimë se me shumën 5,000€ nuk mundem me ndërtuar shkollë apo realizimin e ndonjë projekti tjetër.

z. Bahri Selimi: Planifikimi i projekteve të koduara me nga 5,000€ nuk është keq, por që tani nuk është duke funksionuar raporti me nivelin qendror për me ndihmuar realizimin e projekteve dhe mjetet po mbesin të pashpenzuara, kështu edhe ne jemi pajtuar që në vitin vijues mos me koduar projekte.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky propozim vendim t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve nga Rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për Transfer dhe Rialokim te mjeteve buxhetore;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kërkoj sqarim përveç bartjes se transfereve, të barkodi, 66445, këto mjete po barten edhe nga të HVK dhe nga GQ. Në këtë rast kemi edhe rialokimin e mjeteve me shumën nga 5,000€. Rialokimet të cilat po bëhet: Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Llanishtë, 5,000€, Përfundimi i rrugës Bob, 5,000€, Rregullimi i trotuarit të rrugës Bob –Doganaj, 5,000€, krejt këto mjete me shumën 5,000€, në cilin kod i keni paraparë. Kodet buxhetore që kanë qenë të ndara, nuk janë realizua. Këtë plani e keni bërë ju e jo ministria. A nuk e keni parapa të arsyeshme me vazhduar me këto kode pa u kthyer projektet?

z. Bahri Selimi: Të ky kod, nuk është realizuar me bartje, tani jemi duke e plotësuar me rezervë e me bartje, mungesën e kontraktme të shërbimeve publike, ku iu shtohen këtij kodi diku 61,000€, për ndërtimin e rrugëve rurale. Të infrastruktura, pika 5, në faqen tjetër shënohet, riallokohen në kategorinë e shpenzimeve kapitale, fondi 10, janë mjete nga transferet, riallokohen. Janë gati 100,100€, ato mjete transferohen të rregullimi i sheshit të qytetit, faza I, 19,558.50€- fondi 10, ato të cilat i kemi hequr vjet, jemi duke i shtuar sivjet, se kontrata është kontratë, 20,600€ jemi duke i transferuar në rregullimin e kanalizimit fekal në f. Begracë dhe 35,841.40€ nga këto kode, në ndërtimin e kanalizimeve fekale dhe atmosferike në lokalitetet; Kaçanik, Dubravë, Kaçanik i Vjetër, Ivajë, Strazhë dhe Doganaj. Kodet për projekte, janë vetëm planifikim, nuk kemi mundur se na dështon bartja e mjeteve, kjo krejt po lidhet me financa, por është subjekti i juaj që po na i prishë matematikat dhe ne po mundohemi me i rregullua

Kryesuesi i Kuvendit: Agim, janë ndarë mjete me një kod buxhetor 5,000€ për ndërtimin e impiantit. Duhet ditur se, impianti nuk ndërtohet me shumën 5,000€. Ne, vit pas viti i lëmë kodet buxhetore, se nuk mundesh me lënë një kod buxhetor pa një vlerë të mjeteve. Dihet se impianti ndërtohet me donacione të qeverisë apo ndonjë donacioni të jashtëm. Nëse na lajmërohet ndonjë donator, ne duhet me pasur kodin, se pa e pasur kodin buxhetor, nuk mundem me realizuar projektin. Asgjë nuk na ka kushtuar neve pse i kemi lënë nga 5,000€, se ato mjete i marrim në fund të vitit, nëse nuk realizohen projektet.

z. Agim Mani: Rregullimi i rrugës Bob, 5,000€, nuk është kryer projekti, ndërkaq tani barten këto mjete. Ky projekt është prioritet dhe është dashur me u kryer.

z. Bahri Selimi: Ky projekt ka pasur me u kryer sivjet, por çështja është se na i kanë përgjysmuar mjetet, se nuk po lejohet bartja e mjeteve të mbetura të vitit 2021. Projektet me kontratë, fjala vjen, Administrata e përgjithshme ka pasur ndërmend me realizuar një parking nëntokësor këtu në komunë. Unë i kam shtuar 50,000€ për këtë projekt me bartje të mjeteve. Edhe Ardita kërkoj me ditur se cilat projekte janë refuzuar. Projektet të cilat na i kanë refuzuar ministria të mjetet e mbetura 319,000€, po mundohemi me i mbuluar përmes transfereve dhe rialokimeve, përndryshe i kishim lënë ende si kode me shpresë se gjendet ndonjë donacion. Ne po i heqim këto projekte pa ndonjë dilemë, sepse nuk është duke funksionuar koordinimi me nivelin qendror, e kemi zgjedhur alternativën e rialokimeve dhe transfereve.

Kryesuesi i Kuvendit: Projektet e koduara ka pasur afat me i lëndë deri në fund të vitit, për me shikuar mundësinë e gjetjes se ndonjë donacioni. Këto projekte po dekodohen në fillim, për shkak se ka prioritete tjera. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për Transfer dhe Rialokim te mjeteve buxhetore. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK nr.00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin nerodime;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Drejtor nëse ka mundësi me na shpjeguar me saktësisht se ku ka me u bërë kjo urë dhe në çfarë përmasa ka me pasur ky projekt dhe ku ka me pasur daljen? Me mirë ka qenë me u zgjeruar ura e Hazirit, sesa me u ndërtuar ura e re, se vendi është jo shumë i përshtatshëm dhe kjo urë me tepër ka me i shërbyer ETC, se aty është edhe stacioni i hekurudhës dhe kjo e pengon.

z. Qamil Stagova: Projekti i urës ka me u ndërtua të hyrja e oborrit të ETC, 116m2 kanë me u shpronësuar, e cila pronë është në emër të Mevlude Dushkaja. Ura pjesa e komunikacionit i ka 6 m gjerësi dhe trotuari në dy anët e urës me nga 2.5m, daljen e ka të pjesa e shkollës, ndërkaq ura ekzistuese nuk i plotëson kushtet. Është vendkalimi i dytë mbi lumin nerodime, përveç urës se konakut.

znj. Ardita Rrahmani: Ura e Hazirit a mbetet apo jo? A është ndërtimi i urës investim i ETC apo i komunës, sepse kur është ndërtuar ETC, është thënë se ka me investuar në ndërtimin e urës ?

z. Qamil Stagova: Ura e Hazirit mbetet, ndërkaq do të shikojmë se a mbetet vetëm për këmbësor apo edhe për vetura. Ura do të ndërtohet me buxhetin e komunës. Kemi menduar me u takuar me përfaqësuesin e ETC, ende nuk jemi takuar. Nëse investojnë diçka ETC është mirë. ETC është vetëm një firmë. Ky është vendkalimi i dytë mbi lumin nerodime, përveç urës se konakut, nuk është vetëm për ETC kjo urë. Kthesa përtej hekurudhës është vetëm 90 shkallë, me çka vetëm veturat e vogla mundën me u kthyer, ndërkaq ato të mëdhatë jo.

z. Bahri Selimi: ETC sa e di unë ka me investuar për kalimin e këmbësorëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Investimi i ETC është për nevoja private. Ne nuk bënë me u thirrur shumë në ato investime. Çdo investim që bënë komuna, dikujt i bien me mirë, sido që të jetë, është investim i cili bëhet për qytetarë dhe nuk mundemi me trajtuar nga ky kënd.

z. Sabedin Vishi: Ura e cila do të ndërtohet do të jetë me funksionale se edhe nënkalimi i këmbësorëve është shumë afër i cili iu shërben këmbësorëve. Ka me u bërë edhe vendkalimi zyrtar me laurë, i cili nuk ka qenë me herët. Nuk është kjo vetëm në shërbim të Elkos, por për krejt atë pjesën e rrugës që lidhet me Dushkajë dhe pjesën tjetër. Të pyetja se a ka me investuar ETC, kemi informacion se ka me investuar për këmbësor, megjithatë ne do të kemi një takim me ETC, nëse investon 10.000€, është i mirëpritur bashkë investimi i tij.

znj. Ardita Rrahmani: A keni biseduar paraprakisht me Mevlude Dushkaja për çështjen e shpronësimit të pronës së saj?

z. Qamil Stagova: Kemi biseduar me kunatin e saj, janë pajtuar. Vlerën e shpronësimit e cakton ministria.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK nr.00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin nerodime. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesë të Parcelave kadastrale 00431-5, 00431-6, 00431-7, 00411-0 në ZK Duraj, për Këmbim me pronën komunale në ZK Duraj;

Kryesuesi i Kuvendit: Të arsyetimi është një gabim teknik, aty ku është Bala të mbiemri, duhet të jetë Fazliu. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Nëse ka mundësi drejtori me na dhënë sqarime të nevojshme, se lënda nuk e ka të bashkangjitur skicën. A ka me u bërë këmbimi në anën e njëjtë të rrugës dhe këmbimi i pronave a përputhet me një pikë të përbashkët?

Kryesuesi i Kuvendit: Është njëfarë skice që është me e qartë se cila pjesë i epët dhe cila i merret. Merret një pjesë e pronës ku është rruga me e gjerë dhe i epët një pjesë ku është rruga me e ngushtë. Kufijtë e parcelës janë afër. Edhe pse të prerja ndoshta drejtor është dashur me ia bërë njëfarë pjese që mos me ardhur prerja shumë në ballë të rrugës. Prerja e drejtë nuk është aq e mirë, mos me na ardhur prerja 90 shkallë në rrugë.

z. Qamil Stagova: Këtu në dukje duket ashtu, se nuk është fotoja me ngjyra, por në gjeoportat duket me mirë prerja.

z. Agim Mani: Ne si po e shohim, në njërën anë e liron rrugën, por në anën tjetër e bllokun rrugën. Unë nuk po shoh zgjidhje, sepse me pronën e cila i epët palës, po ia jep një pjesë të rrugë, kurse ju

po ia merrni një pjesë me të vogël. Unë nuk e shoh këtu që është interesi i përgjithshëm me i madh sesa interesi privat.

z. Qamil Stagova: Sqaroj për parcelat që merret sipërfaqja 51m2, kurse në parcelën tjetër i jep 55m2, kurse i merr 29m2, ndërkaq theksoj se interesi është i dyanshëm.

z. Ramadush Osmani: Aty është trotuari, nuk bien në asfalt pjesa që i epët. Trotuari mbetet brenda, ndërkaq pjesa që i epët është jashtë trotuarit të cilën i kemi hyrë në parcelë, pjesa që na ka mbetur nga trotuari.

z. Agim Mani: Është vështirë me i kuptuar pa qenë fotot e qarta dhe pa dalë në vendngjarje.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky propozim vendim t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesë të Parcelave kadastrale 00431-5, 00431-6, 00431-7 në ZK Duraj, për Këmbim me pjesën e Parcelës kadastrale 00411-0 ZK Duraj. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:08. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët - 07.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 28.04.2023 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfere Malsiu

Makfere Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

